

VENDIM
Nr. 426, datë 4.7.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Administrimi i pyjeve”, për projektin “Zhvillimi i burimeve natyrore”, për kosto lokale, të shtohet fondi në vlerën 1 657 705 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekë.

b) Në programin “Mbrojtja e mjedisit”, për projektin “Transformimi i tregut për panelet diellore (ndryshimet klimatike)”, për kosto lokale, të pakësohet fondi në vlerën 1 657 705 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha